



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201501766/4

Tiranë ___/___/2015

Lënda: *Rekomandim për fillimin e hetimeve ndaj shtetasve N. P. dhe N. M., për veprën penale të "Kryerjes së veprimeve arbitrare", parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal.*

Drejtuar : Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor
Z. Petrit FUSHA

Tiranë

Për dijani : Prokurorit të Përgjithshëm
Z. Adriatik LLALLA

Tiranë

I nderuar zoti Fusha,

Në Institucionin e Avokatit të Popullit ka bërë ankesë shtetasi S.S.. Ankuesi pretendon se, në datën 21.09.2015, rreth orës 23:00, pasi kishte përdorur pije alkoolike në një lokal në Laprakë, ka shkuar te Sheshi "Shqiponja" në Rrugën e "Durrësit", Tiranë. Në pritje të një taksie për të ikur në banesë është ulur pranë një tavoline, e cila ndodhej jashtë një lokali dhe anës rrugës kryesore. Pas pak aty ka ardhur një makinë policie me dy policë. Sipas tij, njëri prej policëve i ka folur dhe e ka sharë atë, por meqënëse ka qënë i pirë nuk e mban mend se çfarë i ka thënë saktësisht. Policët kanë zbritur nga makina dhe njëri prej tyre e ka shtyrë me qëllim për ta futur brenda në makinë. Meqënëse ai nuk kishte bërë ndonjë gjë të kundërligjshme, ka kundërshtuar që të futej në makinën e policisë. Në këtë kohë njëri prej tyre e ka goditur sipër vetullës së djathtë, por ai nuk e ka kuptuar se me çfarë. Ndodhur në këto rrethana, për t'ju shpëtuar policëve ai është laguar me vrap dhe është futur poshtë një kamioni që ndodhej në një rrugicë aty pranë. Policët e kanë ndjekur atë dhe pasi ai ka dalë nga poshtë kamionit e kanë prangosur dhe hipur në makinë. Pasi e kanë hipur në makinë, njëri prej tyre e ka goditur me shpulla në faqe. Më pas ai është dërguar në Spitalin Ushtarak ku i janë qepur e mjekuar plagët e shkaktuara nga goditjet e policëve. Pasi ka marrë mjekimin, ai është dërguar në Komisariatin e Policisë nr. 3 Tiranë ku është arrestuar për veprat penale të "Kundërshtimit të punonjësit të policisë së rendit publik", "Goditjes për shkak të detyrës" dhe të

“Mosbidjes ndaj urdhrimit të punonjësit të policisë së rendit publik” të parashikuara nga nenet 236/2, 237 dhe 242 të Kodit Penal.

Aktualisht ankuesi ndodhet i arrestuar në IEVP Fushë Krujë me masën e sigurisë “arrest në burg” të caktuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për kryerjen e veprave penale të “Kundërshtimit të punonjësve të policisë së rendit publik”, të “Goditjes për shkak të detyrës” dhe të “Mosbindjes ndaj urdhrimit të punonjësit të policisë së rendit publik”, të parashikuara nga nenet 236/2, 237 dhe 242 të Kodit Penal.

Meqënëse gjatë pyetjes së ankuesit, nga punonjësit tanë u konstatuan shenja të dukshme dhune në ballin dhe në pjesët e tjera të trupit të tij, me shkresën e datës 29.09.2015 iu kërkuua Institutit të Mjekësisë Ligjore Tiranë kryerja e ekzaminimit mjekoligjor të shtetasit S.S.. Nga Akt Dëshmia Mjeko-Ligjore nr. 1102, datë 09.10.2015, bërë nga Instituti i Mjekësisë Ligjore Tiranë për shtetasin S.S. rezultoi se, *në trupin e shtetasit S.S. janë konstatuar plagë dhe dërmishje. Këto dëmtime janë shkaktuar me mjet mbretës. Dëmtimet futen në kategorinë e dëmtimeve që shkaktojnë humbje të aftësisë për punë në masën mbi nëntë ditë pushim.*

Nga pyetja e shtetasit L.S., i cili ka qënë i pranishëm në kohën e ndodhjes së ngjarjes rezultoi se, në datën 21.09.2015, rreth orës 23:00, e ka marrë në telefon vëllai i tij S.S., i cili ka thënë që ta priste tek ish dogana me qëllim që të shkonin bashkë në banesë. Ai është takuar me S.S. dhe duke qënë bashkë me të jashtë lokalit, ka parë që pas rreth 10 minutash tek Sheshi “Shqiponja” ka ardhur një makinë policie me dy policë, të cilët pasi ndaluan makinën kanë hyrë brenda në lokalin që ndodhej anës rrugës pranë stacionit të autobuzave të Kamzës. Policët i thanë punonjësit të lokalit që të mbyllte lokalin sepse kishte kaluar orari. Në kohën që policët hipën në makinën e tyre, punonjësi i lokalit i ka thënë S. që të ngrihej nga tavolina sepse do ta mbyllte lokalin. S. është ngritur dhe duke qënë i dehur u ka thënë policëve që të iknin sepse skishin punë me të. Policët e thirrën S. që të shkonte te makina e tyre. Sokoli së bashku me të shkuan te makina pranë derës së pasagjerit. Në debat e sipër, S. i ka fyer policët. Ata kanë zbritur nga makina dhe e kanë kapur atë nga krahët me qëllim që ta fusnin në makinë. Sapo ata e kanë futur në makinë e goditën atë me mjete të forta sipër vetullës së djathtë. Nga goditja S. pati çarje dhe hemoragji. Pas pak sekondash policët e zbritën S. nga makina dhe e goditën përsëri me radio ose me dorezë pistolete. L. ka ndërhyrë duke u thënë policëve se ai ishte vëllai i tij dhe të mos e godisnin. Pas ndërhyrjes së tij, policët e lanë të lirë S.. Mirëpo S. i revoltuar nga goditjet e policëve ka filluar që ti fyejë ata me zë të lartë. Në momentin që policët kanë njoftuar në numrin 129, për të ardhur në ndihmë të tyre forca të tjera, S. është larguar me vrap në drejtim të rrugës së Durrësit. Sapo ai është nisur të largohej ka patur një debulesë dhe është kapur tek një rretë teli që ndodhej anës trotuarit, por pas pak ka vazhduar të largohej përsëri me vrap. Pas largimit të tij, policët e kanë ndjekur atë me makinë, por ai nuk e pa se ku shkoi S.. Më vonë, pas rreth një ore, ai së bashku me vëllanë tjetër S.S. kanë shkuar në Spitalin Ushtarak ku policia kishte dërguar S. për mjekim. Ai ka parë që S. kishte dy plagë çarëse, një në vetullën e djathtë dhe një në ball në anën e djathtë.

Nga punonjësit tanë u pyetën edhe dy punonjësit e policisë Noviol Papuli dhe Nikolin Mardodaj, të cilët kishin shoqëruar në komisariat shtetasin S.S..

Nga pyetja e tyre rezultoi se, në datën 21.09.2015, ata kanë qënë me shërbim nga ora 22:00 deri në orën 06:00 të datës 22.09.2015. Duke ushtruar kontroll në lidhje me zbatimin e orareve të mbylljes së lokaleve, tek Sheshi “Shqiponja” ata kanë konstatuar një lokal të hapur, i cili ndodhej anës rrugës kryesore. Ata u futën në lokal dhe komunikuan me punonjësit e tij. Jashtë lokalit, në hyrje të tij, ishin dy tavolina ku qëndron ulur dy persona. Në kohën që ata hynë dhe dolën nga lokal, njëri prej tyre ka filluar ti fyejë ata me fjalë të ndryshme dhe me zë të lartë. Njëri prej policëve i ka bërë thirrje personit që fyente që të qetësohej dhe të sillej me etikë. Në kohën që punonjësit e policisë kanë hipur në makinë për tu larguar, personi në fjalë filloi ti fyente përsëri ata. Në momentin që punonjësi i policisë Noviol Papuli ka tentuar të zbriste nga makina, ai është afruar tek dera e makinës së policisë dhe e ka penguar atë që të zbriste prej saj duke vazhduar ti fyente. Ndodhur në këto rrethana Noviol ka hapur derën e makinës me forcë dhe pasi i ka bërë thirrje atij që të hipte në makinë sepse do të shoqërohej për shkak të sjelljes fyese ndaj tyre. Ai ka kundërshtuar që të hipte në makinë e të shoqërohej në polici. Në këto kushte punonjësit e policisë e kanë kapur atë me forcë prej krahësh për ta futur në makinë, por ai ka kundërshtuar me forcë ata duke i shtyrë e goditur me grushta e shqelma. Për shkak të kundërshtimit të tij me dhunë, punonjësit të policisë Noviol Papulli i janë shkaktuar dëmtime dhe gërvishje në këmbë, në duar dhe në krahë, si dhe i është grisur këmisha. Ndërsa punonjësit të policisë Nikolin Mardodaj i ka rënë kapelja në tokë. Në një moment ai iu është shkëpur punonjësve të policisë dhe është larguar me vrap në drejtim të Rrugës së “Durrësit”. Pas rreth 50 metrave ai është penguar me një qen dhe është rrëzuar në trotuar, por është ngritur shpejt dhe është futur në një rrugicë e cila ishte pa ndriçim. Ata e kanë ndjekur atë dhe pas disa kërkimesh e kanë gjetur të futur poshtë një kamioni. Pas thirrjes së tyre ai ka dalë nga poshtë kamionit dhe punonjësit e policisë e kanë lidhur atë me pranga dhe e kanë shoqëruar në Komisariatin e Policisë nr. 3 Tiranë. Kur e kanë futur në makinë, ata kanë vënë re se ai ishte i dëmtuar, çarë, në vetullën e djathtë dhe ishte gjakosur. Kur e dorëzuan në komisarjat ata kanë mësuar se ai quhej S.S. dhe ndërkohë bënë kallëzim ndaj tij për veprat penale të “Kundërshtimit të punonjësit të policisë së rendit publik”, “Goditjes për shkak të detyrës” dhe të “Mosbidjes ndaj urdhrit të punonjësit të policisë së rendit publik”, të parashikuara nga nenet 236/2, 237 dhe 242 të Kodit Penal.

Të dy punonjësit e policisë nuk pranuan se e kanë goditur shtetasin S.S. me grushta apo me pajisjet që kanë në dispozicion. Sipas tyre, duke u ndodhur në rrethanat që ai i ka kundërshtuar me dhunë, ata kanë ushtruar të drejtën ligjore të përdorimit të forcës ndaj tij për ta shoqëruar në polici. Ndërsa plagët në vetull dhe në ballë i janë shkaktuar në momentin e rrëzimit të tij në trotuar ose kur ka hyrë e dalë nga poshtë kamionit.

Nga hetimi administrativ i këtij rasti të bërë nga punonjësit e institucionit tonë, si pyetja e ankuesit S.S., e shtetasit L.S., e punonjësve të policisë Noviol Papuli dhe Nikolin Mardodaj, si dhe nga Akt Dëshmia Mjeko-Ligjore nr. 1102, datë 09.10.2015 për shtetasin S.S. rezultoi se, shtetasi S.S. i ka fyer, kundërshtuar me dhunë dhe goditur punonjësit e policisë. Gjithashtu ai nuk iu është bindur urdhrit të tyre për tu shoqëruar në komisarjat.

Ne konstatojmë se, punonjësit e policisë kanë qënë të detyruar të ushtronin forcë ndaj shtetasit S.S., për shoqërimin e tij në organin e policisë për shkak të sjelljes kundërshtuese dhe fyese ndaj tyre, por ata e kanë tejkaluar

masën e përdorimit të forcës dhe nivelin e nevojshëm të saj, duke shkelur parimin e proporcionalitetit të parashikuar në nenin 133/2 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”. Justifikimet e punonjësve të policisë, se shtetasit S.S. plagët çarëse në vetullën e djathtë dhe në ball i janë shkaktuar në momentin e rrëzimit të tij në trotuar ose kur është futur e ka dalë nga poshtë kamionit nuk janë bindëse. Ndërkohë ky justifikim i tyre hidhet poshtë edhe nga deklaratimet e dëshmitarit L.S. të cilat i përshkruam më sipër.

Në përfundim të këtij hetimi administrativ kemi arritur në konkluzionin se, veprimet e kryera nga punonjësit e policisë Noviol Papuli dhe Nikolin Mardodaj ndaj shtetasit S.S., duke e goditur me mjete të forta dhe shkaktuar plagë lineare në vetullën e syrit të djathtë dhe anën e djathtë të ballit nuk është në përputhje me rregullat e parashikuara në aktet normative në fuqi të cilat rregullojnë veprimtarinë e Policisë së Shtetit.

Sjellim në vëmendje se, në bazë të nenit 2 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, *Policia e Shtetit ka për mision ruajtjen e rendit e të sigurisë publike, ruajtjen e personaliteteve të larta shtetërore dhe objekteve të rëndësishme të veçantë, garantimin e zbatimit të ligjit, në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut.*

Ndërsa në nenin 133 të këtij ligji parashikohet se:

“1. Punonjësi i policisë përdor forcën për të përmbushur detyrën vetëm kur kjo është e nevojshme dhe vetëm nëse të gjitha masat e tjera janë të pasuksesshme apo të pamundura.

2. Punonjësi i policisë përdor forcën në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

3. Punonjësi i policisë përzgjedh nivelin e nevojshëm të forcës ndërmjet mundësive të përshkallëzuara, që, ndër të tjera, përfshijnë bindje me fjalë, shtrëngim fizik, mjete goditëse, mjete me lëndë paralizuese, mjete me goditje elektrike, qen policie dhe armë zjarri.....”.

Në rastin në shqyrtim, veprimet e punonjësve të policisë Noviol Papuli dhe Nikolin Mardodaj, duke e goditur me mjete të forta shtetasin S.S. përmbajnë elementët e veprës penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare”, të parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal.

Gjithashtu, ky veprim çënon rëndë edhe imazhin e Policisë së Shtetit dhe dëmton e trondit besimin e publikut tek ky organ.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave të njeriut, nga administrata publike”,* dhe në nenin 21/ç të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, ku thuhet se: *“i rekomandon prokurorisë të fillojë hetime në qoftë se vëren se është konsumuar figura e një vepre penale”,*

REKOMANDOJMË:

Fillimin e hetimeve ndaj punonjësve të policisë Noviol Papuli dhe Nikolin Mardodaj për veprën penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare”, të parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi të na ktheni përgjigje brenda 30 ditëve konform nenit 22 të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar.

Bashkëlidhur po ju dërgojmë në cilësinë e provave fotokopje të dokumentave të mëposhtme:

1. Procesverbali i pyetjes së shtetasit S.S., mbajtur në datën 22.09.2015.
2. Procesverbali i pyetjes së shtetasit L.S., mbajtur në datën 29.09.2015.
3. Procesverbali i pyetjes së shtetasit Noviol Papuli, mbajtur në datën 28.09.2015.
4. Procesverbali i pyetjes së shtetasit Nikolin Mardodaj, mbajtur në datën 28.09.2015.
5. Akt Dëshmia Mjeko-Ligjore nr. 1102, datë 09.10.2015 për shtetasin S.S.
6. Një fotografi e shtetasit S.S.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI